

5.2


Diskutimi

Diskutimi

- Gjatë diskutimit vë re tek këmbimi i informatave dhe mendimeve në mes të palëve biseduese të barabarta.
- Mësimdhënësi fillon dhe e udhëheqë diskutimin. Ai rendit kontributet dhe i vë në ndërlidhshmëri njëri-njëri pranë tjetrit. Sipas rregullit ai bënë përmbledhjen e rezultateve të diskutimit.
- Diskutimi është më shumë se sa një bisedë. Ai kërkon ballafaqim të qartë të qëndrimeve të ndryshme. Secili pjesëmarrës në diskutim duhet të mendojë të shprehë bindshëm mendimin e tij.
- Nuk është e thënë që në fund të diskutimit të arrijmë tek një mendim i përbashkët. Rezultati arrihet edhe në raste kur prezantohen botëkuptimet e ndryshme dhe përpunohen kundërshtimet. Vlen të mendojmë për afrit të qëndrimeve përmes ndonjë kompromisi.
- Vetë diskutimi zgjon kërshtërinë e të menduarit të pavarur dhe përmirëson aftësinë e të shprehurit.

Posaçërisht do të vijnë në shprehje

- Aftësia e shpejtë e kuptimit
- Aftësia për kritikë
- Vlerësimi i pikëpamjeve të ndryshme
- Mbrojtja e ndonjë pozite
- Pranimit i argumenteve më të mira



Krahasuar me bisedën, diskutimi kërkon nga mësimdhënësi aftësi më të mëdha moderatore. Ai duhet të kuptojë, krijojë një atmosferë të lirë. Mësimdhënësi duhet të formulojë pyetje në drejtim të qëllimit të diskutimit. Kjo mund të bëhet ende në formë të mbledhjes së ideve (pyetjet me letra).

Në pjesën e dytë të diskutimit është më se e mundur, aktivizimi i nxënësve të aftë në rolin e udhëheqësve për një pjesë të diskutimit apo edhe të diskutimit në tërësi.

Mësimdhënësi dhe nxënësi

Mësimdhënësi hap dhe udhëheqë diskutimin. Në fund ai zakonisht bënë përmbledhjen e rezultateve.

Nxënësit japin kontributin në diskutim, shkëmbejnë argumente dhe pyesin njëri tjetrin. Gjatë kësaj ata mendojnë që nga qëndrimet e pjesëmarrësve të nxjerrin tema.